

**V E N D I M**  
**Nr. 494, datë 19.9.2000**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.400, DATË 27.7.2000, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJES SË  
PRODHIMIT TË ÇIMENTOS FUSHË-KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimin”, nenit 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të vendimit nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore” dhe të vendimit nr.433, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.400, datë 27.7.2000, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Nënshkrimi i kontratës së shitjes së ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë do të kryhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**